

“BIOPRO ALBANIA” SHPK –STATUTI

KREU I EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1 EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “BIOPRO ALBANIA ALBANIA” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 1.3 Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

NENI 2 SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Ali Demi Pallati nr.6 shkalla 1 kati 1 Ap.1/2 zona kadastale 8150 nr pasurie 7/72+1 Njesia bashkiake nr 1, Tirane 1001 Tirane , Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e ortakeve mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.


NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

- Telemarketing, import-export artikujt të ndryshëm ushqimor dhe industrial, tregeti e përgjithshme, call center, shërbime francize, shitje online.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË



- 5.1** Kapitali i Shoqërisë është 2,000,000 (dy milion) Lekë, i përbërë nga 5 (pese) kuota me vlerën sipas çdo ortaku, ortaku **z. Vasileios Christidis** zoteron 1 kuote që përfaqësohet 40% të kapitalit me vlere 800,000 (teteqindemije) i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **z. Vasileios Christidis** , shtetas Grek, lindur në Selanik,Greqi, më 16 Gusht 1965, mbajtës i pasaportes Nr. AT1670621, banues në Athinë, Greqi, person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar. Ortaku **z.Olsion Ferhati** zoteron 1 kuote që përfaqësohet 10% të kapitalit 200,000 (dyqindemije), i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku. Ortaku **z.Olsion Ferhati**, shtetas shqiptar,lindur në Darzezë,Gramsh më 21 prill 1987, me nr personal I70421110H, banues ne Athinë, Greqi, person madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar. Ortaku **z.Athanasios Markos** zoteron 1 kuote që përfaqësohet 15% të kapitalit 300,000 (treqindemije), i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku. Ortaku **z.Athanasios Markos**, shtetas Grek, lindur në Maletianol, Greqi më 18 qershor 1960, mbajtës i pasaportes Nr. AP5527959, banues në Athinë, Greqi, person madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar. Ortaku **znj. Enkelelda Fishekaj**, zoteron 1 kuote që përfaqësohet 15% të kapitalit 300,000 (treqindemije), i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku shtetase shqiptare,lindur në Vlorë më 22 shtator 1997, me nr personal J75922048C, banues ne Tiranë, Shqipëri, person madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar. Ortaku **z. Adi-Aleksandër Zeneli**, zoteron 1 kuote që përfaqësohet 20% të kapitalit 400,000 (katërqindemije), i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku shtetas shqiptar,lindur në Greqi më 15 shtator 2000, me nr personal K00915066S, banues ne Tiranë, Shqipëri, person madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETET

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Asambleja e ortakeve, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një noteri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 7 BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.

KREU III NDRYSHIMI I KAPITALIT

NENI 8

- 8.1** Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Asamblese se Ortakeve apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2** Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 9 ZMADHIMI I KAPITALIT




- 9.1** Asambleja e Ortakeve, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Ortakeve, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2** Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Ortakeve cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3** Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4** Pas marrjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

KREU IV
ORGANIZIMI I SHOQËRISË
NENI 10
STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

- 10.1** Shoqëria tregtare "BIOPRO ALBANIA" SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :
- Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë si organi vendimmarrës për shoqërinë;
 - Administratorin

NENI 11
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS

- 11.1** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



- 11.2** Asambleja e Ortakeve te Shoqerise merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës "1" të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
- 11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve te Shoqerise. Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.
- 11.4** Nga ana e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursionit të veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - d) vendimet e marra në zbatim të nenit 9 të këtij statuti.
- 11.5** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.


NENI 12 MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMMARRËS

- 12.1** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.
- 12.2** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise thirret nga kryesisht nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise ,administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise,thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU V ASAMBLEJA E ORTAKEVE, FINANCIMET

NENI 13 ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- 13.1** Asambleja e Ortakeve te Shoqerise i Shoqërisë është ortaku **z. Vasileios Christidis** shtetas Grek, lindur në Selanik, Greqi, më 16 Gusht 1965, mbajtës i pasaportes Nr. AT1670621, banues në Athinë, Greqi. Ortaku **z.Olsion Ferhati** shtetas shqiptar, lindur në Darzezë, Gramsh më



21 prill 1967, me nr personal 1704211107, banues ne Athine, Greqi, Ortaku **z.Athanasios Markos** shtetas Grek, lindur ne Maletianol, Greqi me 18 qershor 1960, mbajtes i pasaportes Nr. AP5527959, banues ne Athine, Greqi. Ortaku **znj. Enkeleda Fishekaj**, shtetase shqiptare, lindur ne Vlore me 22 shtator 1997, me nr personal J75922048C, banues ne Tiranë, Shqipëri, person madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Ortaku **z. Adi-Aleksandër Zeneli**, shtetas shqiptar, lindur ne Greqi me 15 shtator 2000, me nr personal K00915066S, banues ne Tiranë, Shqipëri, person madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar

NENI 14 VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 14.1** Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, ne perputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime ne lidhje me: (i) ndryshimin e ketij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogelimin e kapitalit te Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave te Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.
- 14.2** Asambleja e Ortakeve te Shoqerise duhet te merren me shkrim dhe te regjistrohen ne regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

NENI 15 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 15.1** Të drejtat dhe detyrat e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise janë:

- Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise;
- Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
- Të informohet mbi përmbajtjen e raportit te administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspertit kontabël;
- Të përfitoje nga fitimi i shoqërisë;
- Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

NENI 16 FINANCIMI I SHOQËRISË

- 16.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejte të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2** Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

KREU VI ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 17 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 17.1** Shoqëria administrohet nga 2 (dy) Administratorë të cilët emërohet nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë rrizgjedhje. Administratorë e parë të Shoqërisë emërohet:

- **Znj. Enkeleda Fishekaj**, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë më 22 shtator

- 1997, me nr personal J/09220480, banues ne Tirane,
• **Z.Olsion Ferhati** shtetas shqiptar, lindur në Darzezë, Gramsh më 21 prill 1987, me nr personal I70421110H, banues ne Athinë, Greqi

17.2 Në zbatim të këtij neni, administratori përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.

17.3 Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organeve të tjera të Shoqërisë.

NENI 18 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

18.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblese se Ortakeve te Shoqerise për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) raportojë përpara Asamblese se Ortakeve te Shoqerise në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

NENI 19 PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT

19.1 Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje te Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 20 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

20.1 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU VII KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 21 KONTROLLI KONTABËL

21.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e

Ortakeve te Shoqerise do te emeroje nje apo me shume eksperte kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

- 21.2** Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 22 VITI FINANCIAR

- 22.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 23 BILANCI DHE REZERVAT

- 23.1** Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Asambleja e Ortakëve te Shoqerise të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

- 23.2** Asambleja e Ortakëve te Shoqerise vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

- 23.3** Asambleja e Ortakëve te Shoqerise në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

NENI 24 PUNËSIMI NË SHOQËRI

- 24.1** Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.


KREU VIII PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 25 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 25.1** Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Asambleja e Ortakëve te Shoqerise.

- 25.2** Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakëve te Shoqerise emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshëm te përfundimit te tyre. Shoqëria priset ne këto raste:

- Kur nuk mund të përmbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
- Me vullnetin e ortakëve;
- Me vendim të Gjykatës
- Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj



NENI 26
PROCEDURAT QË NDIQEN

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare "BIOPRO ALBANIA" SHPK vendoset nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise kur priset shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar ne Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 26.3** Në qoftë se Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Asambleja e Ortakeve te Shoqerise zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.
- 26.5** Në fund të procesit të likuidimit thirret Asambleja e Ortakeve te Shoqerise për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.


NENI 27
NJOFTIMET

- 27.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 27.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU IX
BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË

NENI 28

- 28.1** Shoqëria "BIOPRO ALBANIA" SHPK me anë të bashkimit mund ti kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron te njëjtin aktivitet.
- 28.2** Gjithashtu shoqëria "BIOPRO ALBANIA" SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 28.3** Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.
- 28.4** Transferimi i plotë i aktivitetit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise.



**KREU X
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 29
LIGJI I ZBATUESHËM**


29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 30

30.1 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

**Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
Te
SHOQËRISË “ BIOPRO ALBANIA” SHPK**

Βασίλειος Χριστίδης
Z. Vasileios Christidis



Znj. Enkeleda Fishekaj

Enkeleda Fishekaj

Z. Adi-Aleksandër Zeneli

Adi-Aleksandër Zeneli



Date 07.06.2021

Z. Olsion Ferhati

Olsion Ferhati

Athanasios Markos

ΑΘΑΝΑΣΙΟΣ ΜΑΡΚΟΣ